

ADA HAZIZOLLI

Qeveria ka marrë vendimin për kompensimin e pronarëve, toka e të cilëve është zënë nga ndërtime informale.

Gazeta boton ditën e sotme emrat e 544 familjeve, që do të marrin paratë për truallin, në masën 57% të vlerës së përgjithshme. Për kompensimin e tyre do të ndahen 253 milionë lekë.

Vendimi i qeverisë për kompensimin e pronarëve të shpronësuar
Legalizimet, 544 pronarët që marrin 253 milionë lekë

Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Vlorë, Shkodër e Kukës



pronarët e shpronësuar adresohet 70% e fondit të arkëtuar nga procesi i pajisjes me leje të qytetarëve që kanë ndërtaur në tokë shtet dhe tokë me pronarë. Këta të fundit kanë "detyrimin" për të paguar për truallin e zënë

me lehtësirat dhe reduktimin që parashikon ligji i ri. Kështu, këto familje e përfitojnë tokën me gjysmën e vlerës së tregut, por jo më shumë se 2000 mijë lekë metri katror për zonat urbane dhe 1500 lekë për komunat. Gjysma e

shumës së faturuar mund të paguhet me letra me vlerë, saqë për pagesat e menjëhershme, pra brenda 45 ditëve nga marrja e faturës, aplikohet zbritja prej 20%. Të ardhurat që mblihdhen nga ky proces, në pjesën dërr

rmuese, pra 70%, përdoren për pronarët dhe 30% shkojnë për llogaritë të ALUIZ-NI-t, për mbulimin e shpenzimeve operative. Kompensimi i pronarëve të truallit bëhet pasi është realizuar shpronësimi i tyre me ven-

dim qeverie, ku toka u ka kaluar atyre që kanë ndërtaur pa leje. Këta të fundit, pasi shlyejnë pagesën dhe lidhin kontratën te noter, pajisen me leje legalizimi. Kjo praktikë pasohet më tej nga regjistrimi në Hipotekë i parcelës ndërtimore në emrin e tyre.

LISTA E PRONAREVE QE MARRIN PARATE E KOMPENSIMIT

Table with 7 columns: Emër Mbiemër Atësi, Komuniteti Mysliman Shqiptar, and various family names and compensation amounts.

ZYRA PËRMBARIMIT GJYQËSOR KORÇË

Me datë 31.03.2015, ditën e Martë ora 16:00, përfundon ankandi i parë për pasurinë: "Aparthament" me nr.pasurie 2/55-4-3, Z.K. 8564, regjistruar në Z.V.R.P.P. Korçë, e ndodhur në Bulevardi "Demokracia", P.2, shk.4, K.2, ap.3, Korçë.

Studio Përmbarimore DEBIT COLLECTION sh.p.k

Me datë 31.03.2015, ora 16:00 për pasurinë e huajtshme aksionet e shoqërisë REI-ENERGJI me NIPITL22818201N, me adresë Fshati Topçias, komuna Shëngjin Elbasan, në pronësi të Shoqërisë EKO BEFON sh.p.k. Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi është 134.400 Euro.

Studio Përmbarimore DEBIT COLLECTION sh.p.k

Me datë 30.03.2015, ora 16:00 për pasurinë Njësi me sipërfaqe 157,5 m2, e ndodhur në Zk. 8160, Nr. Pasurie 2/87, Ul. 33, Fqage 43, me adresë Rr. "M. Matohiti", Tiranë, në pronësi të Natasha Ulqinaku. Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi është 24.696.000 lekë.

